

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, neneve 16, 19 paragraf 1.11 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Komisioni ad hoc për përgatitjen e listës dhe shpërndarjen e pakove/rroba të reja , donacion nga Shoqata humanitare “KINDER AUGEN”- Germany, të destinuar për qytetarët në nevojë, në këtë përbërje:

1. Fitore Blakçori, kryesuese
2. Avni Maloku, anëtar
3. Adem Ajvazi, anëtar

Naser Rashiti - në cilësinë e monitoruesit nga Shoqata humanitare “KINDER AUGEN”

Neni 2

Komisioni do të bëjë shpërndarjen e 119 pakove me rroba të ndryshme të klasifikuara dhe të mbyllura në pako, të destinuar:

- 50 pako për SHFMU “Kongresi i Manastirit” në fshatin Gllamnik;
- 30 pako për SHFMU “ Ali Hadri” në fshatin Obrancë dhe paralelet e saj në fshatrat Peran dhe Katunishtë;
- Pakot tjera shpërndahen për familjet në nevojë.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni informon Kryetarin e Komunës përmes Drejtorive përkatëse.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-0045834/21
Podujevë, 08 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes Thirrjes publike të dt. 19.05.2021, nxjerr:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-ve NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve për financimin publik të projekteve në “ **Art në Hapësira Publike**”, kategoria **Art Vizual-Figurativë**, sipas Thirrjes publike publikuar më 19.05.2021, themelohet komisioni në përbërje:

1. Teuta Ismajli, kryesuese, zyrtare për manifestime - Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
2. Ardonis Jusufi, anëtar, zyrtar i të hyrave financiare - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
3. Haxhere Ajvazi, anëtare, shefe e thesarit - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
4. Behar Gashi, anëtar- shoqëria civile
5. Rigon Begolli, anëtar- shoqëria civile

Agim Idrizi, zyrtar për rini në kuadër të DKRS-së, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Arkivit

Nr. 02-020/04-0046805/21
Podujevë, 10 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit Ujërave Natyrës Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit dhe nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1

Ngritet Komisioni për shqyrtimin e ankesave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe natyrës si dhe në fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor në Komunën e Podujevës, në përbërje:

1. Bujar Aliu, kryesues
2. Naxhije Haliti, anëtare
3. Rrahmon Cakiqi, anëtar

Neni 2

Komisioni ka për obligim shqyrtimin e të gjitha ankesave ndaj vendimeve të Drejtorive të Komunës që kanë të bëjnë por pa u kufizuar me lejet komunale mjedisore, lejet ujore, të mbrojtjes së natyrës dhe lejet ndërtimore.

Neni 3

Mandati i Komisionit është një (1) vit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Arkivit*

**Nr.02-020/04-0047079/21
Podujevë, 11 qershor 2021**



**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja (b) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neni 81 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës nr.04/L-042 (I ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet: Nr.04/L-237, 05/L-068, 05/L-092) dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (61.4 dhe 61.15), në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës të Prokurimit, Kryetari i Komunës, nxjerr:

V E N D I M **PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS SË PROKURIMIT**

Neni 1

Për menaxhimin (mbikëqytjen) e Kontratës së Prokurimit nr. 61519027511 në projektin “Ndërtimi i Bulevardit të sheshit “Sheshi i Dëshmorëve” në qendrën e qytetit”, caktohen:

- 1. z.Musli Kutleshi, ing. i dipl. i ndërtimtarisë**
- 2. z.Veton Aliu, ing. ing. i dipl. i arkitekturës**

Zëvendësimi i znj. Florie Mani menagjere e deritanishme e kontratës së cekur të prokurimit, nga z. Veton Aliu, bëhet për shkak të problemeve shëndetësore të familjes së të përmendurës dhe nevojës për përkujdesjen e tyre.

Neni 2

Menaxherët e kontratës detyrat dhe përgjegjësitë i ushtrojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik dhe dispozitat përkatëse nënligjore.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohen vendimet për menaxhimin e kontratës së prokurimit Nr.61519027511 me Nr.prot.02-020/05-0090152 i datës 26 nëntor 2019 dhe Nr.prot.02-020/05-0024556/21 i datës 18 mars 2021.

Nr.02-020/05-0043970/21
Podujeve, 01 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20, dt. 30.09.2020, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0032458/21, dt. 30.04.2021, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR NDARJEN E MËSHQERRAVE PËR FERMERË NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Në kuadër të projektit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, “Përkrahja e fermerëve me mëshqerra”, ndahen 70 shtatëdhjetë mëshqerra për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës.

Neni 2

Ndarja e mëshqerrave bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë/blegtorisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/04-0048555/21
Podujevë, 16 qershor 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë

I

Urdhërohen zyrtarët Zyrës së Prokurimit që në asnjë rast të mos lejojnë vizita dhe qëndrim të përfaqësuesve të operatorëve ekonomik në zyrat e prokurimi, me përjashtim të rasteve kur të njëjtit zyrtarisht ftohen për nënshkrimin e kontratës eventuale të prokurimit apo për ndonjë çështje që ndërlidhet dhe ka të bëjë me ndonjë aktivitet të prokurimit.

II

Qëndrimi i personave të pa autorizuar (përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë apo personat që kanë ndërlidhje me operatorët ekonomikë) në Zyrat e Prokurimit është në kundërshtim me rregullativën ligjore.

III


Në rast të mos zbatimi të kësaj urdhërese do të ndërmerren masa përkatëse ligjore ndaj çdo zyrtari të Zyrës së Prokurimit.

IV

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet Zyrës së prokurimit

Nr.prot.02-016/01-0048902/21
Podujevë, 17 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Gjashtëdhjetë (69) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 7,800.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listat e rekomanduara nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Listat e përfituesve të ndihmës financiare janë pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0048893/21
Podujevë, 17 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare (datë 21.06.2021) nga ana e Komisionit vlerësues të përzgjedhjes së OJQ-ve në Komunën e Podujevës për realizimin e projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore “Art në Hapësira Publike”, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE-OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ në Komunën e Podujevës, për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore “**Art në Hapësira Publike**”, sipas Thirrjes publike dt. 19.05.2021, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **6,500.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të programeve/projekteve dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0049927/21
Podujevë, 22 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.02-615/03-0045579/21 të datës 07.06.2021 të OJQ- Klubi i Boksit “Prishtina”, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ –KLUBI I BOKSIT “PRISHTINA”

Neni 1

OJQ- Klubi i Boksit “Prishtina”, për realizimin e Turneut Ndërkombëtar të Boksit “Zahir Pajaziti” që do të mbahet në Podujevë, në pjesën e parë të muajit Korrik 2021, mbështetet me mjete financiare, në shumë 400.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ- Klubi i Boksit “Prishtina”.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03- 0049922 /21
Podujevë, 22 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 paragraf. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0046770/21 të datës 10.06.2021 të OJQ-Shoqëria Kulturo Artistike Josip Relja, të proceduar nga Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ -SHOQËRIA KULTURO ARTISTIKE JOSIP RELJA

Neni 1

OJQ-Shoqëria Kulturo Artistike Josip Relja, për realizimin e koncertit që do të mbahet për ditën e mërgimtarëve më datë 1 ose 2 gusht 2021, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ- Shoqëria Kulturo Artistike Josip Relja.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtorja e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03- 0049919 /21
Podujevë, 22 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës Nr.prot.09-615/03-0048097/21 të datës 15.06.2021 të OJQ-Federata e Triathlonit e Kosovës, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ – FEDERATA E TRIATHLONIT E KOSOVËS

Neni 1

OJQ- Federata e Triathlonit e Kosovës, për realizimin e Garës Ndërkombëtar të Kosova Sprint Triathlon që do të mbahet më 04 Korrik 2021 në fshatin Orllan të Podujevës, mbështetet me mjete financiare, në shumë 300.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ- Federata e Triathlonit e Kosovës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03- 0052337 /21
Podujevë, 30 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi